



Bazuar në nenin 11 të Vendimit mbi financimin e sportit (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi – Dispozitat komunale”, numër 032/19, 019/21), si dhe neni 7 paragrafi 5 i Rregullores së Komisionit, si dhe në lidhje me Konkursin Publik për bashkëfinancimin e programit të punës së organizatave sportive për vitin 2025, me numër 04-614/25-732/2 prej më 07.02.2025, Pëlqimi i kryetarit nr: 01-614/25-1704/5, prej më 28.03.2025. Komisioni për vlerësimin e programeve dhe përcaktimin e masës së mjeteve për organizatat sportive, në seancën e mbajtur me datën 26.03.2025, solli:

Propozim Vendimi **për bashkëfinancimin e programit të punës së organizatave sportive**

I

Komisioni për vlerësimin e programeve dhe përcaktimin e shumës së mjeteve për organizatat sportive propozoi që mjetet për bashkëfinancimin e programeve të punës për organizatat sportive të ndahen si më poshtë:

N.r.	Emri i organizatës sportive	Selia e organizatës sportive	Shuma e mjeteve për bashkëfinancim
1.	Klubi i futbollit “Malësia 2010“	Tuz	13.100,00
2.	Klubi i futbollit “Tuz“	Tuz	4.500,00
3.	Klubi i futbollit “Milesh“	Tuz	4.000,00
4.	Klubi i Xhudos “Deçiq”	Tuz	4.800,00
5.	Klubi i Kërcimit “Tip toe”	Tuz	4.800,00
	Totali		31.200,00

Arsyetim

Neni 11 i Vendimit mbi financimin e sportit (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi – Dispozitat komunale”, numër 032/19, 019/21) përcakton se Komisioni, pas vlerësimit të programit dhe përcaktimit të shumës së mjeteve për organizatat sportive, ia dorëzon Kryetarit të komunës Propozim Vendimin e arsyetuar për bashkëfinancim të programeve të organizatave sportive. Në paragrafin 2 të të njëjtit nen parashikohet që Propozim Vendimi për bashkëfinancim duhet të përmbajë: emrin e organizatës sportive, selinë e organizatës sportive, dhe shumën e mjeteve për bashkëfinancim.

Neni 7 paragrafi 5 i Rregullores së Punës së Komisionit Nr. 04-614/25-723/4 prej më 18.03.2025 parasheh që Komisioni pas vlerësimit të programit të punës së klubeve sportive t'i paraqesë kryetarit të komunës propozim të arsyetuar për bashkëfinancimin e programit të punës së organizatave sportive.

Sekretariati për Vetëqeverisje Lokale i Komunës së Tuzit ka shpallur Konkurs Publik për bashkëfinancim të programit të punës së organizatave sportive për vitin 2025 nr. 04-614/25-732/2 prej më 07.02.2025 dhe e publikoi përmes mediave të shkruara, në ueb faqen e Komunës së Tuzit www.tuzi.org.me si dhe në tabelën e shpalljeve të Komunës së Tuzit.

Në bazë të nenit 10 të Vendimit mbi Bashkëfinancimin e Sportit ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi – Dispozitat komunale", nr. 032/19, 019/21), Kryetari i Komunës me Vendimin nr. 01-614/25-96/5 të datës 12.03.2025, themeloi Komisionin për Vlerësimin e Programeve dhe përcaktimin e shumës së mjeteve për organizatat sportive me detyrë kontrollimin e dokumentacionit të pranuar dhe, në përputhje me dispozitat e Vendimit për financimin e sportit të Komunës së Tuzit dhe Rregullores për kushtet, mënyrën, procedurën, kriteret për ndarjen e mjeteve dhe kontrollin mbi zbatimin e programit për organizatat sportive, përcakton Ranglistën e organizatave sportive që plotësojnë ose nuk i plotësojnë kushtet për financim, përgatit Propozim Vendimin për bashkëfinancimin e programit të organizatave sportive dhe ia paraqet kryetarit të komunës.

Në bazë të nenit 7 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së Komisionit, Komisioni për vlerësimin e programeve dhe përcaktimin e shumës së mjeteve për organizatat sportive ka përcaktuar Rang listën e klubeve sportive që plotësojnë kushtet e parapara me konkursin publik për vitin 2025.

Vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur është kryer bazuar në kriteret e përcaktuara nga Rregullorja mbi kushtet e detajuara, mënyrën, procedurën, kriteret për ndarjen e fondeve dhe kontrollin mbi realizimin e programeve për organizatat sportive, nr. 01-614/25-732/1 të datës 04.02.2025. Ky vlerësim është bërë bazuar në formularët e dorëzuar nga organizatat sportive, për të cilat ato mbajnë përgjegjësi penale dhe materiale për saktësinë e të dhënave të paraqitura. Fondet nga Buxheti i komunës, të destinuara për bashkëfinancimin e organizatave sportive, do të përdoren për financimin e programeve të punës së organizatave sportive që plotësojnë kushtet e përcaktuara nga konkursi publik, në masën 90%, ndërsa 10% e fondeve me pëlqimin e kryetarit të komunës, shpërndahen bazuar në vendimin e drejtuesit të organit kompetent për klube sportive, organizata sportive ose individë, me qëllim nxitjen e zhvillimit të sportit dhe kulturës sportive, si dhe në rrethana të tjera specifike që sekretariati përgjegjës i konsideron të justifikueshme. Fondet e përcaktuara nga Rregullorja shpërndahen në përqindjet e mëposhtme: 60% për sportet ekipore dhe 40% për sportet individuale, nga buxheti i përgjithshëm i parashikuar për shpërndarje përmes Konkursit Publik.

Komisioni ka kryer vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur, bazuar në kriteret e përcaktuara nga Rregullorja, dhe ka përcaktuar se klubet sportive kanë arritur rezultatet e mëposhtme:

Në kategorinë e sporteve ekipore:

1. Klubi i Futbollit "Malësia 2010" Tuz – 407 pikë
2. Klubi i Futbollit "Tuz" Tuz – 179 pikë
3. Klubi i Futbollit "Milesh" Tuz – 160 pikë

Në kategorinë e sporteve ekipore:

4. Klubi i Xhudos "Deçiq" Tuz – 506 pikë
5. Klubi i Kërcimit "Tip toe" Tuz – 503 pikë.

Komisioni për ndarjen e mjeteve për klubet sportive i shqyrtoi aplikimet e dorëzuara për konkursin në fjalë dhe duke zbatuar kriteret e përcaktuara me Rregulloren e bëri këtë propozim, me të cilin i propozoi Kryetarit të Komunës që të marrë Vendim për ndarjen e mjeteve klubeve sportive nga dispozitat e këtij Propozimi. Klubet sportive janë të detyruara që mjetet e paguara nga buxheti i Komunës së Tuzit t'i përdorin ekskluzivisht për qëllime të miratuara. Klubi sportiv që keqpërdor mjetet për bashkëfinancimin e programit të punës është i obliguar që me kërkesë të Komunës së Tuzit t'ia kthejë shumën totale të mjeteve të paguara.

E DREJTA LIGJORE: Pjesëmarrësi i konkursit ka të drejtë t'i paraqesë Komisionit një Kundërshtim të arsyetuar për Propozim Vendimin brenda 8 ditëve nga data e publikimit të tij.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv

KRYETARJA E KOMISIONIT,

Marina Ujkaj

